

AIDA

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2023

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
01	16.1.2023	Më 2/12/2021 Komiteti i Investimeve Strategjike miratoi statusin “Investitor strategjik procedurë e veçantë” për kompaninë “Mediterranean Wave”, për ndërtimin e një kompleksi turistik në plazhin e Gjeneralit, fshati Pqejnaj, Bashkia Kavajë. [REDAKTUAR] po përgatit një material investigativ mbi procedurën e ndjekur	25.1.2023	Procedura e ndjekur për dhënien e statusit të investitorit strategjik dhe mbi aktivitetin e kësaj kompanie, nëse ajo i ka kapacitetet për të ndërtuar projektin e propozuar, është e bazuar në Ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” , i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave të Ministrave nr. 1026, dt. 16/12/2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike” , dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi , që rregullojnë fushën e investimeve strategjike. Në këtë prizëm, subjekti aplikues më datë 17.08.2021 , ka depozituar për aplikim dokumentacionin e projektit me potencial strategjik për realizimin e projektit investimi në sektorin e turizmit “Mediterranean Wave”. Përmes aplikimit, subjektet aplikues kërkoi përfitimin e Statusit të Investitorit	E plotë	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

	<p>për dhënien e këtij statusi dhe mbi aktivitetin e kësaj kompanie, nëse ajo i ka kapacitetet për të ndërtuar projektin e propozuar.</p> <p>Referuar ligjit Nr. 119/2014 PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT, Neni 3, [REDAKTUAR] kërkon nga Agjencia juaj që t'i vihet në dispozicion procedura e ndjekur për dhënien e këtij statusi kësaj kompanie.</p> <p>Gjithashtu kërkojmë nga ana juaj të dimë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në ç'fazë është investimi? 2. Çfarë përmban projekti? 3. A i ka kompania që ju i keni dhënë statusin e investitorit strategjik kapacitetet financiare për ta realizuar këtë projekt? 4. 		<p>Strategjik/Investim Strategjik Procedurë e Veçantë, në zbatim të Nenit 8, pika 3, c, i, të Ligjit Nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Kreut I, pika 3, c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 "Për nënsektorët strategjikë dhe zonat me përparësi zhvillimi”.</p> <p>Në kuadër të aplikimit, është kryer procesi i identifikimit kadastral dhe situatës juridike të pronës e cila synohet të preket nga projekti “Mediterranean Wave”. Kështu, referuar masave mbështetëse të kërkuara nga subjekti aplikues, për të realizuar regjistrimin fillestar, i ka adresuar institucioneve përkatëse shkresat duke kërkuar verifikim kadastral, si më poshtë: <u>Me datë me dt. 14.06.2021 AIDA ka adresuar shkresat për institucionet e mëposhtme:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • AIDA iu drejtua me shkresë zyrtare me Nr.346/6 Prot., datë 14.06.2021, ATP për verifikime nëse ka vendim për njohje, kthim apo kompensim mbi pasurinë me nr. 106/22, ZK.2909, Bashkia Kavajë. <p>ATP me shkresë Nr. 4994/1 Prot., datë 18.06.2021 sqaron se referuar sistemit WEB-GIS pranë ATP-së, nga të dhënat e pasqyruara deri më tani, nuk rezulton të ketë vendime për njohje, kthim apo kompensim prone për pasurinë nr.106/22, ZK.2909, Bashkia Kavajë.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. AIDA iu drejtua me shkresë zyrtare me Nr. 346/1Prot., datë 14.06.2021 AKPT ku, kërkon bashkëpunimin për të 		
--	--	--	---	--	--

		<p>Cilat janë benefitet e shtetit nga ky projekt? 5. Sa përqind zënë hotelet/hoteli dhe sa vilat private?</p>		<p>mundësuar informacion mbi pasaportën e zonës sipas planeve kombëtare dhe sektoriale të planifikimit të territorit për pasurinë nr.106/22, ZK.2909, me vendndodhje në Bashkinë Kavajë</p> <p>AKPT me shkresë Nr. 744/1Prot., datë 16.06.2021 sqaron se Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendim Nr. 2 datë 27.04.2018 ka miratuar “Planin e Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kavajë”.</p> <p>Gjithashtu, Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin Nr. 7 datë 28.12.2020 ka miratuar “Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kavajë”.</p> <p>AKPT ka bërë verifikimet përkatëse të Dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kavajë, nga ku rezulton se pasuria Nr. 106/2 e ndodhur në ZK.2909, përfshihet në dy zona:</p> <p><u>Zona A</u> e cila bën pjesë në Njësitë Strukturore me Kode: S5-B4-01, N3-03, N1-01, S5-N5-02, B42-01, N1-50 dhe IN-01;</p> <p><u>Zona B</u> e cila bën pjesë në Njësitë Strukturore me Kode: S5-B42-01 dhe N3-03</p> <p>Gjithashtu, brenda territorit të Zonës A ndodhet edhe monumenti i natyrës</p>	
--	--	---	--	---	--

				<p>“Faleza e Bardhoit”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • AIDA iu drejtua me shkresë zyrtare me Nr. 346 Prot., datë 14.06.2021 Instituti Kombëtarë të Trashëgimisë Kulturore për informacion nëse projekti prek monumente apo sipërfaqe me status të veçantë. <p>Instituti Kombëtarë i Trashëgimisë Kulturore me shkresë Nr. 1065/1Prot., datë 18.06.2021 sqaron se brenda zonës ku do të realizohet investimi, në pasurin 106/22, ZK.2909, Bashkia Kavajë, nuk ndodhen objekte me status “monument kulture”, “qendër historike” dhe as sipërfaqe me status “zonë arkeologjike” ose “zonë e mbrojtur”, megjithatë pranë saj ndodhet pasuria kulturore e “Kalas së Turrës dhe zones mbrojtëse të saj”, 200m nga kufiri i zonës mbrojtëse, në fshatin Domen, Bashkia Rrogozhinë.</p> <p>Në mbështetje te ligjit Nr. 27, date 17.05.2018, “Për Trashëgimin Kulturore dhe Muzetë”, neni 134, pika 1, subjekti zhvillues duhet të marrë miratimin e KKTKM.</p> <ul style="list-style-type: none"> • AIDA iu drejtua me shkresë zyrtare me Nr. 346/3 Prot., datë 14.06.2021, Avokaturës së Shtetit, ku kërkoi informacion nëse, Avokatura e Shtetit ka ndjekur apo nëse aktualisht ka ndonjë çështje gjyqësore në proces për 	
--	--	--	--	--	--

				<p>pasurin me nr. 106/22, e cila ndodhet në ZK.2909, Bashkia Kavajë.</p> <p>Avokatura e Shtetit me shkresë Nr. 2645/1Prot., datë 22.06.2021 sqaroi se nga verifikimet e bëra rezultoi se, aktualisht, ekziston një çështje gjyqësore në proces, me pale paditëse Arben Lako, dhe pale të Paditur Agjencinë e Trajtimit të Pronave, me objekt: “Njohje Pronar”, për pasurin me Nr. 1/11, në ZK.2909, Bashkia Kavajë.</p> <p>Kjo çështje gjyqësore ka për objekt pasurin, e cila ndodhet në të njëjtën zonë kadastrale me pasurinë 106/22, ku do të realizohet projekti i ri i investimit, është e nevojshme që të kryhen verifikimet pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me qëllim identifikimin e çdo konflikti eventual pronësor apo mbivendosje të pronave në zonën kadastrale 2909, Bashkia Kavajë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • AIDA iu drejtua me shkresë zyrtare me Nr. 346/5Prot., datë 14.06.2021, AKZM <p>AKZM me shkresë Nr. 711/1Prot., datë 21.06.2021 sqaron se brenda zonës ku propozohet të zhvillohet projekti strategjik për realizimin e një resorti, në ZK.2909, në pasurit nr.106/22, Bashkia Kavajë, ndodhet monumenti natyror “Foleza e Bardhorit”, shpallur me VKM, Nr. 303, datë 10.05.2019 “Për</p>	
--	--	--	--	---	--

				<p>miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”, në të cilën zbatohet shkalla më e lartë e mbrojtjes. Monumentet natyrore rrethohen nga zona buferike me gjerësi deri në 20 metra nga merimetri i monumentit .</p> <p>Për sa më sipër kërkohet që në planifikimin e ndërhyrjeve, të respektohet distanca për të shmangur dëmtimet e mundshme në këtë monument.</p> <ul style="list-style-type: none"> • AIDA iu drejtua me shkresë zyrtare me Nr. 346/4Prot., datë 14.06.2021, AKZM <p>AKZM me shkresë Nr. 711/3 Prot., datë 07.07.2021 sqaron se brenda zonës ku propozohet të zhvillohet projekti strategjik për realizimin e një resorti, në ZK.2909, në pasurit nr.106/22, Bashkia Kavajë, ndodhet monumenti natyror “Foleza e Bardhorit”, shpallur me VKM, Nr. 303, datë 10.05.2019/ VKM nr. 187, datë 25.03.2021 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në“ Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”, në të cilën zbatohet shkalla më e lartë e mbrojtjes.</p> <p>AKZM ka vënë në dispozicion edhe koordinatat e monumentit, duke kërkuar që gjatë zhvillimit të projektit, të ruhet gjendja natyrore e këtij monumenti,</p>	
--	--	--	--	---	--

				<p>referuar nenit 17, të ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • AIDA i drejtua me shkresë zyrtare me Nr. 346/6Prot., datë 14.06.2021, Bashkisë Kavajë duke i kërkuar informacion për realizimin e projektit të një resorti turistik në pasurin 106/22, ZK.2909, për zonën e bregdetit. <p>Bashkia Kavajë me shkresë Nr. 1769/1Prot., datë 23.06.2021 sqaron se pasuria me nr 106/22 Vol.7 faqe 70, ZK. 2909 me sipërfaqe 806013m2 nuk është trajtuar me ligjin 7501 datë 19.07.1991.</p> <p>Në këtë sipërfaqe nuk ka ndarje tjetër të tokës si dhe pretendues nga ish pronarët e vjetër.</p> <ul style="list-style-type: none"> • AIDA i drejtua me shkresë zyrtare me Nr. 346/2Prot., datë 14.06.2021, Këshillit të Qarkut Tiranë duke kërkuar informacion nëse ka Akte të Marrjes së Tokës në Pronësi në zonën ku do të zhvillohet projekti. <p>Këshilli i Qarkut Tiranë me shkresë Nr. 632/1Prot., datë 21.06.2021 sqaron se pasuria me nr. 106/22, ZK. 2909, nuk është trajtuar me ligjin 7501, date 19.07.1991.</p> <p>Në zbatim të detyrave të përcaktuara nga legjislacioni sektorial për investimet strategjike, AIDA, në cilësinë e strukturës administrative</p>		
--	--	--	--	---	--	--

			<p>kompetente për dhënien e shërbimeve për investitorin në një “dritare unike” për investitorët strategjikë, i ka përsjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentacionin e projektit dhe, bazuar në kërkesën e paraqitur, u ngrit grupi operacional i vlerësimit të projektit, i përbërë nga ekspertët e ministrive të linjës, të fushave të cilat prekën nga projekti i paraqitur, përkatësisht nga MFE, MIE, MTM, MBZHR, dhe Bashkia Kavajë.</p> <p>Para shqyrtimit të projektit nga grupi operacional, u vlerësua paraprakisht se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekti i paraqitur i përket sektorëve dhe nënsektorëve strategjike – në përputhje me Nenin 8 të Ligjit Nr. 55/2015 dhe Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015; • Investimi i kalon vlerat minimale të investimit të përcaktuara nga neni 8, pika 3/c e Ligjit Nr. 55/2015. Vlera e këtij projekti investimi parashikohet të jetë 50.409.836 mln Euro; • Projekti aktual parashikon hapjen e 80 vendeve të punës; • Koha e realizimit e cila është 5 vjet; • Subjekti legjitimohet si aplikues; • Subjekti mbulon kriterin financiar të kërkuar sipas legjislacionit; • Projekti vlerësohet nga MIE në përputhje me PPV Bashkia Kavajë; <p>Të gjitha kriteret e lart-përmendura u aprovuan nga anëtarët e Grupit Operacional dhe u konfirmua e drejta e subjektit për të aplikuar për status strategjik.</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>Pas vlerësimit teknik, në bazë dhe zbatim të legjislacionit të investimeve strategjike, specifikisht Neni 21 të Ligjit Nr. 55/2015, Grupi Operacional vlerësoi masat mbështetëse që mund t'i ofrohen investitorit në rastin e procedurës së asistuar, të cilat janë:</p> <p><i>Neni 21</i></p> <p><i>Pas marrjes së vendimit për dhënien e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”, investitori, nëpërmjet “dritares unike” (Agjencia), mund të përfitojë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, shërbime dhe lehtësi të llojit:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. kryerje e veprimeve përgatitore, përgatitje e dokumenteve dhe aplikim administrativ</i> <i>2. me procedurë të përshpejtuar nga agjenti asistues, përfshirë dokumentet e nevojshme që shoqërojnë aplikimin, kur ato lëshohen nga një organ i administratës shtetërore, me kërkesë të një organi tjetër të administratës shtetërore;</i> <i>3. trajtim me prioritet të përgatitjes së dokumentacionit, dhënies së mendimeve apo ndjekjen e procedurave, të cilat përfshihen në fushën e veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore, të përfaqësuar në grupin operacional, për përgatitjen dhe realizimin e investimit strategjik;</i> <i>4. konsolidim i tokës;</i> <i>5. programe mbështetëse;</i> <i>6. mbështetje me infrastrukturë ndihmëse;</i> 	
--	--	--	--	---	--

				<p>7. <i>vënie në dispozicion të pasurive të paluajshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, sipas legjislacionit në fuqi.</i></p> <p>Pas vlerësimit të Grupit Operacional, aplikimi i është paraqitur Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), i cili vendosi miratimin e tij me Vendimin nr. 11/9 datë 02.12.2021.</p> <p>Në lidhje me pyetjet e tjera, ju sqarojmë se: Për pyetjen 1: Në ç'fazë është investimi? Investimi ende nuk ka filluar nga zbatimi i tij. Në referencë të Vendimit të KIS nr. 11/9 datë 02.12.2021, pikat 10, 11 dhe 12, si dhe Planit të veprimit bashkëlidhur, janë disa detyra/veprime që duhet të realizohen/kryhen nga institucione të ndryshme dhe duke qenë se deri tani, ende nuk kanë përfunduar këto procese, edhe projekti i investimit strategjik nuk ka nisur nga realizimi. Për pyetjen 2: Çfarë përmban projekti? Në vija të përgjithshme, projekti i investimit synon ndërtimin e një Kompleksi Turistik multidimensional në tipologjitë e akomodimit dhe faciliteteve, që do t'i ofrojë pushuesve dhe vizitorëve. Kompleksi do të ketë në përbërje Hotele, Vila Hotelerie (Fshat turistik), Tarace Houses, Bare dhe Restorante të Hotelerisë, Parkime dhe facilitate të Hotelerisë, Parqe dhe hapësira për Aktivitete, Infrastruktura në sheshe e rrugë për automjete dhe këmbësorë dhe sistemime të vijës bregdetare, parqe dhe kënde sportive Struktura akomoduese do të ketë rreth 250 njësi (përfshi vila hotelerie, studio, apartament hotel) 170 dhoma dhe suita hoteli dhe më shumë se 700 vende parkimi 150 tarace houses 5 Parqe të gjelbëruara.</p>	
--	--	--	--	--	--

			<p>Për pyetjen 3: A i ka kompania që ju i keni dhënë statusin e investitorit strategjik kapacitetet financiare për ta realizuar këtë projekt?</p> <p>Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1028, datë 16.12.2015 "Për përcaktimin e marzheve, rregullave dhe dokumentacionit të garancive financiare të investimeve strategjike", parashikon si më poshtë vijon:</p> <p>1. Personat juridikë privatë, vendas e të huaj, të cilët, në cilësinë e subjekteve investuese të interesuara për zhvillimin dhe realizimin e një investimi strategjik, kërkojnë përfshirjen e projektit investues në procedurat administrative të investimeve strategjike, me qëllim marrjen e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar", apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë", përveç dokumentacionit të kërkuar, në lidhje me projektin, duhet të paraqesin, pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, dokumentacionin që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues, si mënyrë garancie për zbatimin dhe zhvillimin e projektit.</p> <p>2. Dokumentacioni që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues duhet të përmbajë të dhëna financiare që dëshmojnë aftësinë e investitorit për realizimin e investimit, në masën jo më pak se 10 % të vlerës totale të tij.</p> <p>3. Garancitë financiare për marrjen e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar" apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë" paraqiten në momentin e aplikimit dhe/ose të nënshkrimit të kontratës, në</p>	
--	--	--	--	--

			<p><i>rastet kur, sipas ligjit të aplikueshëm, nënshkruhet një kontratë e tillë me shtetin.</i></p> <p><i>5. Vlera e kapaciteteve financiare të kërkuara për realizimin e investimit mund të dëshmohet nëpërmjet:</i></p> <p><i>a) kapaciteteve financiare të vetë investitorit, të provuara dhe siç rezultojnë nga pasqyrat financiare të audituara e të depozituara pranë administratës tatimore, të 3 viteve të fundit, kur kjo është e mundur, ose, nëse është themeluar pas këtij afati, të viteve/it të fundit;</i></p> <p><i>b) financimit dhe kreditimit të përshtatshëm, nga ana e instituteve bankare ose financiare, vendase ose të huaja, me reputacion të mirënjohur dhe besueshmëri të lartë;</i></p> <p><i>c) ofrimit të garancive financiare nga ana e instituteve bankare ose financiare, vendase apo të huaja, me reputacion të mirënjohur dhe besueshmëri të lartë.</i></p> <p>Në bazë të sa më sipër, për të dëshmuar kapacitetin financiar të kërkuar, subjekti aplikues ka paraqitur bilancet financiare të vetë investitorit, për vitet 2020, 2019, 2018 dhe 2017.</p> <p>Për pyetjen 4: Cilat janë benefitet e shtetit nga ky projekt?</p> <p>Benefitet e shtetit shqiptar janë vlerësuar, gjithashtu, nga Grupi Operacional, bazuar në dokumentet e paraqitura nga subjekti aplikues, si "Studimi i fizibilitetit", apo "Përfitimet ekonomike, sociale dhe operacionale si dhe niveli i punësimit që parashikohet të realizohet".</p> <p>Vetë legjislacioni sektorial për investimet strategjike parashikon se Investimet strategjike, të përcaktuara si të tilla (në këtë ligj),</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>konsiderohen me interes publik dhe se përcaktimi i interesit publik në përzgjedhjen e një investimi strategjik vlerësohet sipas [1]:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) <i>vlerës së investimit;</i> b) <i>kohës së realizimit të investimit;</i> c) <i>produktivitetit dhe vlerës së shtuar të investimit;</i> ç) <i>hapjes së vendeve të reja të punës;</i> d) <i>prioritetit ekonomik sektorial;</i> dh) <i>zhvillimit ekonomik rajonal dhe lokal;</i> e) <i>zhvillimit apo përmirësimit të kushteve dhe standardeve për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve;</i> ë) <i>ofrimin të teknologjive të reja për të rritur konkurrencën dhe efektivitetin e investimit;</i> f) <i>rritjes së nivelit të përgjithshëm të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve;</i> g) <i>mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit.</i> <p>Në këtë këndvështrim, benefitet e shtetit shqiptar shikohen kryesisht te vlera e lartë e investimit dhe vendeve të reja të punës, që priten të hapen si rrjedhojë e zbatimit dhe implementimit të projektit, por edhe te përputhshmëria e projektit me planin sektorial të zhvillimit të turizmit, duke qenë se sipërfaqja ku do të realizohet investimi shtrihet në Zonë me Përparësi Zhvillimin e Turizmit, të miratuar me Vendimin e KKT Nr. 1, datë 26.07.2018. Kjo sepse turizmi konsiderohet nga qeveria shqiptare si një nga sektorët më të rëndësishëm në rritjen e ekonomisë shqiptare, që gjeneron zhvillim ekonomik, punësim dhe mundësi të</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>vetëpunësimi.</p> <p>Për pyetjen 5: Sa përqind zënë hotelet/hoteli dhe sa vilat private?</p> <p>Lutemi referojuni të dhënave të përgjithshme të projektit, në përgjigjen e pyetjes për pyetjen 2. Duke ju uruar një ditë të mbarë.</p> <p><i>[1] Neni 5 i ligjit 44?2015</i></p>		
02	21.2.2023	<p>Kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje e plotë e praktikës shkresore, të njehsuar me origjinalin, që ka shoqëruar Vendimet nr. 3/5 datë 29.03.2021 dhe nr. 3/9 datë 15.07.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike.</p>	28.2.2023	<p>Pasi u njohëm me kërkesën tuaj, lutemi të gjeni bashkëlidhur:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendimin nr. 3 /5 datë 29.03.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS); 2. Vendimin nr. 3/9 datë 15.07.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS); <p>Sa i përket praktikës shkresore që ka shoqëruar vendimet përkatëse, ju sqarojmë se, si në çdo rast tjetër të vendimeve të KIS, kjo praktikë përbëhet nga dokumentacioni që paraqet subjekti në çastin e aplikimi për përfitimin e statusit investim/investitor strategjik.</p> <p>Vetë AIDA, në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, Neni 13/dh, parashikon se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA <i>‘autorizimin mbi dakordësinë e investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë’.</i></p>	E pjesshme	Nuk ka

				<p>Kjo dispozitë e veçantë zbërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 'Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike' ku në Kreun I, pika 4/gj, parashikohet shprehimisht se: <i>'Dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar'</i>.</p> <p>Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihet deklarata e subjektit aplikues mbi të dhënat apo dokumentacionin në dosje që përcaktohet shprehimisht nga subjekti si konfidencial. Në të tilla kushte, në pamundësi për të cenuar marrëveshjen me subjektin aplikues, por për të ezauruar çdo shqetësim tuajin lidhur me procedurën e ndjekur, ne mbetemi në dispozicionin Tuaj, kurdo që ju e keni të mundur të vini pranë zyrave të AIDA, për të konsultuar dosjen aplikuese ashtu si dhe për të marrë të gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo dokumentacion të dorëzuar dhe shqyrtuar të projekteve të investimit.</p>		
03	8.3.2023	Referuar ligjit "Për të drejtën e Informimit" jemi të interesuar të kemi listën e investimeve	15.3.2023	Pasi u njohëm me kërkesën tuaj, lutemi të gjeni bashkëlidhur tabelën e projekteve të investimeve strategjike, të miratuara nga Komitetii Investimeve Strategjike (KIS). Një	E plotë	Nuk ka

		strategjike në Shqipëri në 10 vitet e fundit dhe investitorët strategjikë (zotëruesit).		informacion më të detajuar lidhur me vendimet në fjalë, e gjeni në faqen zyrtare të AIDA-s, në linkun: https://aida.gov.al/sq/investimet-strategjike/komiteti-i-investimeve-strategjike/vendimet-e-komitetit-te-investimeve-strategjike . Sjellim në vëmendjen tuaj se, në informacione e mësipërm nuk janë përfshirë Vendimet e KIS të marra në Mbledhjen XXII, të datës 1.2.2023, pasi ato janë ende në proces zbardhjeje.		
04	9.3.2023	Emri im është [REDAKTUAR] dhe ju shkruaj nga kompania [REDAKTUAR]. Kompania [REDAKTUAR], është një kompani e cila ofron shërbimin e konsulences së biznesit. Një prej klientëve tane është i interesuar për të realizuar një investim strategjik, në fushën e turizmit. Në funksion të këtij aplikimi, njëra prej kërkesave është mandatpagesa. Lidhur me mandatpagesën, kërkojmë një orientim se ku mund ta terheqim fizikisht atë, ose gjenerojmë onlinë bashku me një informacion	15.3.2023	Pasi u njohëm me kërkesën tuaj, ju sqarojmë se, mandatpagesa përgatitet nga AIDA dhe tërhiqet nga subjekti i interesuar në momentin kur subjekti paraqet dosjen me dokumentacionin e plotë të aplikimit për përfitimin e statusit investim/ investitor strategjik. Tarifa e mandatpagesës është e bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1027, datë 16.12.2015 “Për tarifën e shërbimeve për investim me strategjike”. Vlera e saj është 85.000 lekë dhe paguhet në një prej bankave të nivelit të dytë.	E plotë	Nuk ka

		lidhur me tarifen qe mandatpagesa ka.				
05	10.3.2023	<p>ë</p> <p>është një organizatë e shoqërisë civile e regjistruar në Gjykatë me nr Vendimi . Bazuar në ligjin për të drejtën e informimit, në rrugë elektronike ju lutem na vini në dispozicion: Listën e targave të automjeteve ekzistuese në pronësi të institucionit tuaj.</p>	13.3.2023	<p>Pasi u njohëm me kërkesën tuaj për informacion, të regjistruar me nr. 05 datë 10.3.2023, me anë të të cilit kërkonti <i>Listën e targave të automjeteve ekzistuese në pronësi të institucionit tonë</i>, lutemi gjenimë poshtë informacionin e kërkuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. AA488PK 2. TR6823P 	E plotë	Nuk ka
06	28.3.2023	<p>Ju falenderojme per informacionin e detajuar te cilin na keni ofruar. Ne vijim te komunikimit, klienti te cilin ne po asistojme eshte ne permbyllje dosjes se aplikimit dhe gati per aplikim. Lidhur me proceduren e aplikimit, do te na ndihmonte nje informacion lidhur me ceshtjet e meposhteme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Dosja e aplikimit, 	31.2.2023	<p>Pasi u njohëm me kërkesën tuaj,. Lutemi gjeni informacionin si më poshtë.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Dosja e aplikimit, me dokumentacionin bashkelidhur duhet dorezuar fizikisht dhe online apovetem fizikisht? Ne rast se duhet online, ne cilen adrese duhet dorezuar?</i> 2. <i>Dosja e aplikimit ka nevojë që të dorëzohet dhe në variant elektronik në CD/USB?</i> <p>Po, të gjithë dokumentet e dosjes origjinale të aplikimit duhet të jenë të skanuara dhe të dorëzohenedhe në variantin elektronik.</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>me dokumentacionin bashkelidhur duhet dorezuar fizikisht dhe online apo vetemfizikisht? Ne rast se duhet online, ne cilen adrese duhet dorezuar?</p> <p>2. Dosja e aplikimit ka nevojë që të dorëzohet dhe në variant elektronik në CD/USB?</p> <p>3. Në sa kopje duhet dorëzuar dosja e aplikimit?</p> <p>4. Dokumentacioni në dosje duhet të jetë patjetër i noterizuar apo mund të mjaftojë dhe me fotokopje?</p> <p>Keto çështje, por dhe të tjera, të cilat mund të jenë ngritur nga aplikante të tjere, do të na ndihmonin shumë!</p>		<p>3. Në sa kopje duhet dorëzuar dosja e aplikimit?</p> <p>Doja e aplikimit duhet të dorëzohet në 2 kopje: një dosje me dokumentet origjinale dhe një dosje me dokumentet fotokopje të noterizuara.</p> <p>4. Dokumentacioni në dosje duhet të jetë patjetër i noterizuar apo mund të mjaftojë dhe me fotokopje?</p> <p>Dokumentet mund të jenë edhe të noterizuara. Dokumentet e lëshuara nga ente/institucione të huaja, duhet të jenë të përkthyer, noterizuara dhe apostiluara, sipas legjislativës në fuqi. Dokumentet etjere private të hartuara apo anëshkruara në gjuhë të huaj, duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe, kur është rasti, edhe të noterizuara.</p> <p>Për çdo informacion apo sqarim të nevojshëm, mund të lini një takim pranë zyrave të AIDA-s mes specialistëve përkatës të Drejtorisë së Investimeve.</p>		
07	30.3.2023	Kërkoj vënien në dispozicion të vendimit të zbardhur	13.4.2023	Pasi u njohëm me shkresën tuaj... ju vëmë në dispozicion informacionin si më poshtë vijon:	E plotë	Nuk ka

		të KIS sipas kërkesës nr. 17/1 prot. datë 05.12.2022, si dhe informacion mbi procedurën e miratimit të akteve nënligjore për vënien në dispozicion të tokës, sipas VKIS nr. 3/8 datë 15.7.2021.		<p>1. Bashkëlidhur gjeni një kopje të Vendimit të zbardhur të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 17/2 datë 1.2.2023;</p> <p>2. Procedura e miratimit të akteve nënligjore për vënien në dispozicion të tokës, sipas Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 3/8 datë 15.7.2021, sikurse ju kemi bërë me dije edhe më parë, është duke u ndjekur nga MBZHR dhe MFE.</p> <p>Sidoqoftë, tani, me zbardhjen edhe të vendimit nr. 17/2 datë 1.2.2023, AIDA do të njoftojë institucionet përkatëse mbi parashikimet e këtij vendimi të marrë pas kërkesës suaj të radhës dhe do t'ju njoftojë sapo ta marrë përgjigjen përkatëse.</p>		
08	30.3.2023	A është informuar zyrtarisht MBZHR nga AIDA, sipas përcaktimit të germës c) të pikës 4.2 të Kreut IV të VKM-së nr. 373 datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore”, e ndryshuar, se paralelisht po	13.4.2023	<p>Pasi u njohëm me kërkesën tuaj, ju sqarojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresat nr. 2888/3 prot datë 09.04.2019 dhe nr. 3045/5 prot. datë 12.04.2019, ka kërkuar informacion mbi disa pasuri në lidhje me procesin e dhënies me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për disa parcela, në zonën kadastrale 3085, të cilat ndodhen në Karavasta të Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë, Qarku Fier. Këtyre shkresave AIDA u është përgjigjur me shkresën nr. 145/1 prot. datë 30.04.2019.</p> <p>Kopje të shkresave i gjeni bashkëlidhur.</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me</p>	E plotë	Nuk ka

		trajtohej kërkesa e subjektit “Aquatiq”sh.p.k. për marrjen e statusit të investitorit strategjik për realizimin e projektit “Ferma Aquaponike”, në të njëjtën zonë edhe për të njëjtat parcela?”		shkresën nr. 6357 prot. datë 09.08.2019 ka kërkuar informacion në lidhje me procesin e dhënies me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për disa parcela, në zonën kadastrale 3085, të cilat ndodhen në Karavasta të Re, Njësia Administrative Remas, Bashkia Divjakë, Qarku Fier. Kësaj shkresë AIDA i është përgjigjur me shkresën nr. 299/1 prot. datë 3.9.2019. Kopje të shkresave i gjeni bashkëlidhur. Gjithashtu, pas regjistrimit të aplikimit tuaj në AIDA më datë 20.1.2020, AIDA ka njoftuar, sipas përcaktimeve nënligjore, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për ngritjen e Grupit Operacional, ku në përbërje të tij janë përfshirë edhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Bashkëlidhur gjeni edhe shkresën nr. 3/1 datë 24.1.2020.		
09	05.04.2023	Kërkojmë nga ju të na jepet informacioni i kërkuar: 1. Sa investime strategjike ka në Republikën e Shqipërisë? 2. Specifikoni tipologjinë e investimeve strategjike (llojin)? 3. Sa investitorë strategjikë ka të ndara sipas ministrive, psh: Ministria e Turizmit,	18.04	Përhëndetje znj. Shpataj, Përmes e-mailit të datës 5.4.2023 ardhur nga Kryeministria, jemi njohur me kërkesën tuaj për informacion, të regjistruar në AIDA me nr. 09 datë 5.4.2023, përmes të cilit kërkonte informacionin: 1. Sa investime strategjike ka në Republikën e Shqipërisë? 2. Specifikoni tipologjinë e investimeve strategjike (llojin)? 3. Sa investitorë strategjikë ka të ndara sipas ministrive, psh: Ministria e Turizmit, Bujqësisë etj? 4. Kush janë investitorët strategjikë(emrat	E plotë	Nuk ka

		<p>Bujqësisë etj?</p> <p>4. Kush janë investitorët strategjikë(emrat e kompanive, personit fizik)?</p> <p>5. Në çfarë zonash janë këto investime strategjike?</p> <p>6. Në çfarë viti e kanë marrë statusin e investitorit strategjikë?</p>		<p>e kompanive, personit fizik)?</p> <p>5. Në çfarë zonash janë këto investime strategjike?</p> <p>6. Në çfarë viti e kanë marrë statusin e investitorit strategjikë?</p> <p>Pasi u njohëm me kërkesën tuaj, lutemi të gjeni bashkëlidhur tabelën e plotë të investimeve strategjike, në të cilën gjenden të gjitha informacionet e kërkuara nga ana juaj. Për më shumë informacion mund të konsultoni edhe vendimet e publikuara në faqen zyrtare të institucionit https://aida.gov.al/sq/investimet-strategjike/komiteti-i-investimeve-strategjike/vendimet-e-komitetit-te-investimeve-strategjike</p> <p>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.</p>		
10	28.4.2023	<p>A e keni informuar zyrtarisht MBZHR-në AIDA, se paralelisht po trajtohej kërkesa e subjektit “Aquatiq”shpk, për marrjen e statusit të investitorit strategjik, për realizimin e projektit të ”Fermës Akuaponike”, në të njëjtën zonë dhe për të njëjtat parcela?</p>	3.5.2023	<p>Me shkresën tuaj nr. 26/1 prot. (hyrë në AIDA me nr. 3/58 prot. datë 28.4.2023), regjistruar me nr. 10 datë 28.4.2022, kërkonte informacionin:</p> <p><i>A është informuar zyrtarisht MBZHR nga AIDA, se paralelisht po trajtohej kërkesa e subjektit “Aquatiq” për marrjen e statusit të investitorit strategjik për realizimin e projektit “Ferma Akuaponike”, në të njëjtën zonë edhe për të njëjtat parcela?”</i></p> <p>Pasi u njohëm me kërkesën tuaj, ju sqarojmë se, informacioni i dërguar me shkresën tonë, me nr. 3/57 prot. të datës 13.4.2023, është i plotë dhe ezaures.</p>	E plotë	Nuk ka
11	3.5.2023	<p>1- Cfare informacionesh jepni ju mbi transaksionet e</p>	11.5.2023	<p>Përmes e-malit të datës 3.5.2023, regjistruar në AIDA e nr. 11 datë 4.5.2023, keni kërkuar</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>bizneseve te huaja? 2- Si mund te informohet nje person i interesuar mbi historikun e transaksioneve qe ka bere njekompani e huaj? 3- A ka ndonje projektligj apo plan per te permirësuar gjurmimin e transaksioneve të investimeve?</p>		<p>informacion si më poshtë: <i>Çfare informacionesh jepni ju mbi transaksionet e bizneseve te huaja?</i> <i>Si mund te informohet nje person i interesuar mbi historikun e transaksioneve qe ka bere nje kompani e huaj?</i> <i>A ka ndonje projektligj apo plan për të përmirësuar gjurmimin e transaksioneve të investimeve?</i> Pasi u njohëm me kërkesën tuaj, ju informojmë se Agjencia Shqiptare e Zhvillimi të Investimeve (AIDA), për natyrën e funksioneve dhe kompetencave të veta ligjore dhe nënligjore, nuk zotëron informacione në lidhje me transaksionet e bizneseve të huaja dhe as është në dijeni në lidhje me informimin mbi historikun dhe as mund t'ju orientojë dot në lidhje me ndonjë projektligj apo plan mbi gjurmimin e këtyre transaksioneve.</p>		
12	29.5.2023	<p>Pershendetje, Per shkak te nje procesi gjyqesor qe po zhvillohet ne gjykatën e juridiksionit te pergjithshem Gjirokaster ju lutem na vini ne dispozicion nje kopje te shkreses tuaj me lende kthim pergjigje per av. [REDACTED].</p>	29.5.2023	<p>Përsëndetje, Pasi u njohëm me përmbajtjen e emailit të datës 29.5.2023 të regjistruar në AIDA me Nr.12 datë29.5.2023 , konstatojmë se kërkesa nuk është bërë në respektim të parashikimeve të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe akteve të dala në dhe për zbatim të ti j. Më konkretisht, neni 11 i ligjit të sipërcituar, parashikon që kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë</p>	Refuzuar	Nuk ka

				identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Gjithashtu, duke pasur parasysh edhe udhëzimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, lutemi që për të kërkuar informacionin, t'i referoheni edhe Programit të Transparencës të publikuar nga AIDA në faqen zyrtare, në linkun https://aida.gov.al/Programi_i_transparences_2.html Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,		
13	18.07.2023	Interesohesha për sa i përket rezultateve të grantit të shpallur në Shtator 2022. Jam përfaqësuar që të telefonoja po ka disa muaj që e keni nxjerr jashtë funksionit. Ju lutem më informoni me ceshtjen pasi nuk është bërë asnjë lajmerim në asnjë pjesë të marrës. Si për PO ose për JO! [REDACTED]	27.07.2023	Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se numri zyrtar i telefonit më të cilin AIDA operon ka patur ndërprerje të sinjalit për arsye teknike. Së fundmi, pas komunikimeve të vazhdueshme me agjentin përfaqësues të shoqërisë [REDACTED], kemi mundur të vendosim në funksion numrin e telefonisë fikse, në të cilën keni tentuar të na kontaktoni. Sa më lartë, duke qenë se ky numër është funksional, jeni të lutur të na kontaktoni për çfarë do lloj pyetje, në çdo moment.	E kufizuar	Nuk ka
14	18.07.2023	Sa mëtej katror bregdet është përfituar përmes investimeve strategjike? Cilat janë koordinatat? Sa është numri i projekteve të	28.07.2023	Në cilësinë e kërkuarit keni depozituar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), kërkesën për dhënie informacioni, dërguar me e-mailin e datës 18.07.2023, dhe regjistruar me Nr. rendor 13, datë 18.7.2023 përmes së cilës kërkon: 1. Sa mëtej katror bregdet është	E plotë	Nuk ka

		<p>shënuara si investime strategjike nga 2015 deri në Korrik 2023? Sa nga këto investime strategjike janë të ardhura nga jashtë vendit? Sa janë vetëm vendase dhe sa janë të përbashkëta? Cili sektor ka më shumë investime strategjike dhe sa është numri? Numri i investimeve strategjike që prekin bregdetin e jugut.</p>		<p>përfituar përmes investimeve strategjike?</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Cilat janë korodinatat? 3. Sa është numri i projekteve të shënuara si investime strategjike nga 2015 deri në Korrik 2023t? 4. Sa nga këto investime strategjike janë të ardhura nga jashtë vendit? 5. Sa janë vetëm vendase dhe sa janë të përbashkëta? 6. Cili sektor ka më shumë investime strategjike dhe sa është numri? 7. Numri i investimeve strategjike që prekin bregdetin e jugut <p>Pasi u njohëm me kërkesën tuaj, gjeni disa sqarime lidhur me pyetjet tuaja:</p> <p>Në lidhje me pyetjet 1 dhe 2:</p> <p><i>1. Sa meter katror bregdet është përfituar përmes investimeve strategjike?</i></p> <p><i>2. Cilat janë korodinatat?</i></p> <p>ju sqarojmë se :</p> <p>Sa i përket investimeve strategjike dhe vendimeve të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) për miratimin e statusit investim/investitor strategjik, sqarohet se "pronat shtetërore" mund të vihen në dispozicion të një investimi strategjik, si masë mbështetëse, në përputhje me kërkesat</p>		
--	--	--	--	---	--	--

			<p>e ligjit nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</p> <p>Mes tyre, më konkretisht, neni 29 "E drejta e përdorimit të brigjeve" i ligjit në fjalë, parashikon se:</p> <p><u>Lejimi i përdorimit të brigjeve të detit, liqeneve, lumenjve dhe shtretërve të tyre, si dhe zonave përkatëse, në funksion të realizimit të një projekti investues strategjik, miratohet me vendim të veçantë nga Këshilli i Ministrave, me propozim nga Komiteti i Investimeve Strategjike, pas marrjes së mendimit paraprak nga institucionet, kompetencat e të cilave shtrihen në këto zona.</u></p> <p>Në bazë të sa më sipër, Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) miraton masën/masat mbështetëse, në fjalë, vetëm parimisht, ndërsa miratimi përfundimtar bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave, pas përmbushjes së detyrave përkatëse që (vendosen) lihen nga KIS për institucionet shtetërore, mes të cilave edhe verifikimi i koordinatave respektive.</p> <p>Në çdo rast, sqarojmë se, pavarësisht vendimeve të Këshillit të Ministrave, e drejta e përdorimit të pronave shtetërore vihet në dispozicion vetëm pas nënshkrimit</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>të kontratës respektive, referuar legjislacionit të fuqi. Në këtë aspekt, jo të gjitha projektet strategjike, të cilave u është miratuar masa mbështetëse si më sipër me VKM, kanë kontratë me strukturat përkatëse shtetërore. Për këtë, për një informacion më të detajuar, duhet t'ju drejtoheni pikërisht strukturave shtetërore të ngarkuara nga Vendimi i KIS dhe/ose VKM përkatëse për nënshkrimin e kontratës në fjalë për të drejtën e lejimit të përdorimit të brigjeve të detit.</p> <p><u><i>Në tabelën bashkëlidhur, gjeni Projektet e investimit për të cilat janë miratuar VKM për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit.</i></u></p> <p>Në lidhje me pyetjen 3, 4, 5, 6 dhe 7:</p> <p><i>3. Sa është numri i projekteve të shënuara si investime strategjike nga 2015 deri në 2022 Gusht?</i></p> <p><i>4. Sa nga këto investime strategjike janë të ardhura nga jashtë vendit?</i></p> <p><i>5. Sa janë vetëm vendase dhe sa janë të përbashkëta?</i></p> <p><i>6. Cili sektor ka më shumë investime strategjike dhe sa është numri?</i></p> <p><i>7. Numri i investimeve strategjike që prekin bregdetin e jugut</i></p> <p>Ju bëjmë me dije se të gjitha vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike</p>	
--	--	--	--	--

				<p>gjenden të publikuara në faqen zyrtare web të AIDA- s: https://www.aida.gov.al/sq/investimet-strategjike/komiteti-i-investimeve-strategjike/vendimet-e-komitetit-te-investimeve-strategjike .</p> <p>Vendimet në fjalë përmbajnë të gjitha informacionet që ju kërkoni, si për sa i përket numrit dhe sektorëve që i përkasin, vendeve ku synohen të realizohen ashtu si edhe subjektet juridike (tregtare) investuese.</p>		
15	09.10.2023	<p>Qysh nga shkurti i kaluar, Ju (AIDA) nuk keni publikuar asnjë vendim të KIS. Sa më sipër, ju parashtroj këtë kërkesë për informacion,</p> <p>1. Kopje e plotë, përfshirë hartat shoqëruese dhe anekset përkatëse të vendimeve të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), për periudhën mars 2023 e deri tani.</p>	26.10.2023	<p>Ne vijim te komunikimeve me subjektin pergjigja e kthyer si me poshte vijon:</p> <p>Ne link me poshte gjeni vendimet e zbardhura te KIS.</p> <p>https://mab.to/t/xh3whLDEAXo/eu1</p> <p>Per ato projekte te miratuara, e te cilat kane Aneks, lutemi ne bashkelidhje gjeni respektivisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aneks te projektit White Roads • Ankes te projektit San Pietro • Aneks te projektit Jala Entertainment Park • Ankes te projektit Plantacioni molle dhe 	E plotë	Nuk ka

		<p>2. Sa është numri i investitorëve potencialë (ndërtim hotelesh, fshatrash turistikë apo agrobiznese) që kanë shprehur interes për kryerjen e investimeve, në 2023, në territorin e bashkisë Divjakë. Cila prej ketyre propozimeve (një brief lidhur me këtë projekt) ka aplikuar, apo tenton marrjen e statusit Investim/investitor strategjik?</p> <p>3. Një kopje të raportit vjetor 2022.</p>		luleshtrydhe, Sheqeras.		
16	17.11.2023	<p>Për arsye studimore si dhe bazuar në ligjin Nr. 119/2014 date 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, kërkoj nga ana Juaj vënie në dispozicion të informacionit si më poshtë:</p> <p>1. Cili është sektori me nr. më të madh të përfituesve të statusit</p>	20.11.2023	<p>Ne vijim te kerkeses suaj ju sqarojme si me poshte vijon:</p> <p>Te gjitha vendimet e Komitetit te Investimeve Strategjike (KIS) te trajtuara nga AIDA jane te publikuara ne webin e AIDA sipas link me poshte:</p> <p>https://www.aida.gov.al/sq/investimet-strategjike/komiteti-i-investimeve-strategjike</p> <p>Referuar nenit 18 te ligj 55/2015, i ndryshuar, ne permbajtje te vendimit te Komitetit te Investimeve Strategjike perfshihen elementet e</p>	E plote	Nuk ka

		<p>Investitor strategjik që prej hyrjes në fuqi të ligjit? Nga këta përfitues dominojnë investitorët vendas apo të huaj?</p> <p>2. Sa është nr. i vendimeve të marra nga KIS që prej hyrjes në fuqi të ligjit?</p> <p>3. Sa është nr. i përfituesve të statusit Investitor strategjik në sektorin e turizmit dhe sa prej tyre kanë përfituar këtë status nëpërmjet procedurës së veçantë? Po nr. i përfituesve në zonat bregdetare?</p> <p>4. A është publik Regjistri i investimeve strategjike dhe nëse jo cila është arsyeja përse ky regjistër nuk është i aksesueshëm?</p>		<p>meposhtem:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Titulli i projektit investues; • Vlera e parashikuar të kapitalit që do të investohet; • Lloji i projektit investues; • Vendi/zona ku do të zhvillohet projekti investues; • Afati për të cilin jepet statusi “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”. <p>Webi i AIDA ka sherbyer si Regjister Publik, ne te cilin jane publikuar te gjitha vendimet e marra nga KIS qe nga fillimi i zbatimit te ligjit 55/2015 i ndryshuar e deri me sot.</p> <p>Per sa me siper, lutem konsultimin e webit per te marre te gjithe informacionin e kerkuar.</p>		
17.	30.11.2023	<p>Nese eshte e mundur te informohem mbi afatin ligjore te drejtes se aplikimit per Statusin e Investitorit strategjik. Ne baze te ligjit Nr. 130/2021, per disa</p>	04.01.2023	<p>Lidhur me kerkesen tuaj ju informojme se referuar bazes ligjore aktuale ne fuqi afati i perfundimit te aplikimeve per perfitimin e statusit investim/investitor strategjik eshte data 31.12.2023.</p>	E plotë	Nuk ka

		<p>shtesa ne Ligjin 55/2025, neni 36 eshte percaktuar si afat perfundimtar “data 31 dhjetor 2023”.</p> <p>Nese eshte e mundur te me konfirmohet perfundimisht nese eshte ende ne fuqi data e perfundimit te aplikimit date 31.12.2023, apo ka ndryshuar?</p>				
--	--	--	--	--	--	--